

GJYSMA TJETËR E QIELLIT
POETE GREKE TË SHEKULLIT XX DHE XXI
ANTOLOGJI POETIKE

BOTIMET TOENA

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

Poete greke të shekullit XX dhe XXI

Antologji poetike

Përzgjedhja *dhe* Prologu nga
Sotiris Pastakas – Stavros Gkirgkenis

Përktheu nga origjinali greqisht Maklena F. Nika

Botimet Toena

Titulli në origjinal: **ΤΟ ΑΛΛΟ ΜΙΣΟ ΤΟΥ ΟΥΡΑΝΟΥ**

Ελληνίδες ποιήτριες του εικοστού αιώνα

Ky publikim u mbështet nga Ministria Greke e Kulturës dhe Sporteve dhe Fondacioni Grek për Kulturën në kuadër të programit GreekLit.

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Kopertina dhe përkujdesja gra ike: Elsa Hajderaj

ISBN

© 2020 Εκδόσεις Ζήτρος

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, nr. 7,

Tiranë 1023.

K. Postare 1420.

Tel.: + +355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Parathënie për botimin në shqip

Cila është “Gjysma tjetër e Qiellit”?

Rreth shekullit të 3-të pas Krishtit, në një mbishkrim të gurtë në Epidavër, u gjet e gdhendur “*Himn për Nënë e Perëndive*” e poeteshës lirike Telesila (shek. 6-5 para erës sonë), e cila me heroizëm mbrojti atdheun e saj, Argos, kur u sulmua nga mbreti i Spartës Kleomeni, në vitin 494 para Krishtit. *Nëna e Perëndive*, Nëna e Olimpiti i kërkon Zeusit gjysmën e qiellit, gjysmën e tokës dhe një të tretën e detit:

*Nga qiejt ejani, perëndesha
dhe bashkë me mua thurni himne
për Nënë e Perëndive
që këtu mes nesh e kemi
pasi u end nëpër male e pyje*

*nuk do të kthehem te perënditë
nëse pjesën time nuk e marr
gjysmën tjetër të qiellit
gjysmën tjetër të tokës
dhe një të tretën e detit
vetëm atëkohë do të shkoj.*

Në një pasdrekë paksa të mjegullt prilli 2021, duke pirë një kafe në një nga zonat më të dashura për mua në Athinë,

Plaka, e duke naviguar në internet, lexova se “*Gjysma tjetër e qiellit*” ishte një botim i fundit që përmblihte 160 poetesha greke. Kërshëria që më lindi nga ky titull intrigues ishte e mjaftueshme për mua të ngrihesha menjëherë e të shkoja në librari për ta blerë. Kështu nisi ky projekt përkthimi i cili gjeti mbështetjen e menjëhershme të Irena Toçit, e gatshme për të bashkëpunuar që në propozimin e parë. Gjej rastin ta falënderoj për besimin e dhënë bashkë me redaktorin letrar Eris Rusi. Mbi të gjitha, falenderuese dhe mirënjohëse për Fondacionin Grek të Kulturës, Athinë, i cili mundësoi financiarisht këtë botim voluminoz.

Në një bashkëpunim të hershëm, që në vitin 2007 me Qendrën e Librit, Selanik dhe Ministrinë e Kulturës, Greqi, kam realizuar një studim të thelluar të përkthimit dhe receptimit të letërsisë së re greke përkthyer në gjuhën shqipe, i botuar në një vëllim të veçantë “...*γνώριμος και ζένος... η Νεοελληνική λογοτεχνία σε άλλες γλώσσες*”, Botimet “Qendra e Gjuhës Greke”, 2012. Nga ky studim, por jo vetëm, pasi interesi im akademik vijon të jetë i njëjtë për të analizuar letërsinë greke të përkthyer në gjuhën shqipe edhe në ditët e sotme, kam vërejtur se një antologji poetike e letërsisë femërore greke i ka munguar lexuesit shqiptar. Në historinë e përkthimologjisë, numri i antologjive poetike të shkrimtarëve grekë arrin në dhjetëra të tilla, dhe përpjekjet e të gjithë përkthyesve janë për t’u vlerësuar. Ajo që më ka bërë përshtypje është numri i ulët i shkrimtareve gra të përfshira në këto antologji, që me keqardhje e pranoj se arrin deri në 20-30 përqind të totalit të shkrimtarëve të përfshirë.

Në historinë e letërsisë botërore, që në shekujt e lashtësisë, gratë iu drejtuan poezisë duke sfiduar normat

shoqërore me një kurajë që buron nga shpirti i tyre i pasur dhe hyjnor. Nga vargjet erotike të Sapfosë, epigramet mesjetare të Kassias e deri te fjalët revolucionare të Sylvia Plath dhe poetëve bashkëkohore feministe, poezia femërore ka riformësuar vazhdimisht traditat letrare dhe ka thelluar të kuptuarit tonë për përvojën njerëzore. Vetëm pas shekullit të 19-të, mund të themi që gratë poete filluan të formojnë gjuhën e tyre krejtësisht personale. Feminizmi padyshim luajti një rol vendimtar në këtë drejtim: nuk është rastësi që koncepti i subjektivitetit u avancua nga teoricienet femra të kohës sonë (ndër to Julia Kristeva dhe Catherine Clement), të cilat kundërshtuan hapur diskursin e ngurtë dhe autoritar të gjinisë mashkullore me lëvizshmërinë e vazhdueshme, poliseminë dhe disponueshmërinë subversive të shprehjes femërore.

Poezia femërore në Greqi ka një traditë të fortë që shtrihet nga lashtësia deri në ditët e sotme dhe pasqyron zhvillime interesante zhanresh, stilesh dhe tematikash. Ajo daton që 26 shekuj më parë dhe rishfaqet fuqishëm në Greqinë post-revolucionare. Për sa i përket poezisë moderne greke, gratë e nisën rrugëtimin e tyre në dekadat e para të shekullit XX. Peizazhi i brendshëm i shqetësuar dhe i fragmentuar, përvoja e heshtur, dhimbja erotike dhe ekzistenciale, ndjesia e fortë fizike, si edhe kalimi gradual nga tradita në modernizëm, surrealizëm dhe manifestimet e para të postmodernizmit, na shfaqin elementët e panjohur të këtij udhëtimi të gjatë, i cili do të pasqyrojë një bashkërendim të mitologjisë së natyrës dhe jetës së përditshme me imazhet arkaike apo luftën me kuptimet e pashprehura dhe të padukshme të gjuhës. Ajo mund të karakterizohet si poezi emocionale, gjinore, intro-

spektive, herë e marginalizuar e herë emancipuese.

Në këtë antologji, “*Gjysma tjetër e qiellit*”, zërat e poeteshave greke na ftojnë në një univers magjik poetik shumëngjyrësh, me qiej të kaltër, me nebuloza shpirtërore e metafizike, me diej përvëlues e hëna drithëruese, me toka të buta e të ashpra, me dete të thellë e batica e zbatica ndjenjash. Këto shkrimtare, që së pari janë gra, nëna, vajza apo mbesa trajtojnë një mozaik shumëdimensional çështjesh ekzistenciale të tilla si dashuria, humbja, mungesa, kujtesa, identiteti personal, trupi femëror, kërkimi i vetvetes, tensioni midis lirisë personale dhe pritshmërive shoqërore, përkohshmëria, mbijetesë, historia, ndjenja patriotizmi etj. Fjalët e tyre mbartin një forcë të pamohueshme, duke zbuluar të vërteta drithëruese personale dhe kolektive.

Duke përkthyer këto poezi, e gjeta veten në një univers poetik me një shumëllojshmëri ndjeshmëri dhe një përdorim gjuhësor unik për çdo poete. M’u desh të depërtoja thellë e të bashkëidentifikohesha me 160 tipologji poetesh e të ndieja ritmin dhe nervin poetik të gjithësecilës prej tyre. Duke marrë frymë thellë pas përkthimit të çdo poeteshe, e duke rindjerë e reflektuar për çdo varg, për çdo metaforë simbolike apo çdo koncept të trajtuar, përgatitja veten për t’u ulur në tavolinë me një tjetër poeteshë, një tjetër heroinë që do të më dhuronte emocione të reja dhe të panjohura. Ky proces përkthimi ka qenë më shumë se një sprovë përkthimore me gjuhën dhe stilin. Më tepër, ka qenë një angazhim apo përvojë intelektuale thellësisht prekëse, duke më tronditur apo riformësuar çdo koncept apo mit të njohur e të panjohur për mua, çdo perceptim apo këndvështrim të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm tek unë.

Shpresoj që lexuesi shqiptar, ashtu sikurse unë, të pyesë veten e të gjejë përgjigjen e duhur se *cila është kjo gjysma tjetër e qiellit?* Në një kuptim astronomik, gjysma tjetër e qiellit i referohet hemisferës së padukshme të sferës qiellore - pjesa që mbetet e fshehur nga shikimi ynë në çdo kohë. Pse Telesila kërkonte me ngulm gjysmën tjetër të qiellit? A do të ishte e mjaftueshme gjysma tjetër e qiellit për një grua poete, që të pushtonte në vazhdim edhe pjesën e mbetur?

Le të shërbejë kjo antologji si një dritare në poezinë femërore greke dhe si një ftesë për të eksploruar horizonte të reja letrare. Sot, poezia femërore po njihet gjithnjë e më shumë, duke thyer barrierat tradicionale dhe duke fituar vendin e merituar në kanunin letrar. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme, poezia femërore vazhdon të lulëzojë, duke formësuar ligjërimin letrar me thellësinë, autenticitetin dhe fuqinë e saj emocionale. A e hap vërtet letërsia e shkruar nga gratë rrugën për një univers tjetër dhe nëse po, çfarë marrëdhënie ka një univers i tillë me universin e burrave? A është ajo armiku i betuar i tij, duke mbetur në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të, apo thjesht propozon një perspektivë alternative, duke projektuar një lloj ndjeshmërie që ligjërimi mashkullor nuk do ta fitojë kurrë?

Çdo grua, jo vetëm poete, është një *Lilith* hyjnore, qiellore, e pamposhtur, një Helenë e bukur, një Circe magjistare, një Evë mëkatare apo një Kleopatër joshëse. Një demon i pamposhtur që, në të vërtetë, e ka pushtuar të gjithë hapësirën qiellore...

Maklena F. Nika

PËRMBAJTJA

Parathënie për botimin në shqip	5
PROLOG	13
LIBRI I PARË: POETESHAT E LINDURA DERI NË VITIN 194	17
LIBRI I DYTË: 1946-1965	223
LIBRI I TRETË: 1966-1975	407
LIBRI I KATËRT: 1976-1985	491
LIBRI I PESTË: 1986 E NË VAZHDIM	571
POETET E PËRFSHIRA NË KËTË ANTOLOGJI	589

PROLOG

gjysma tjetër e qiellit...
(Telesila, shekulli 6-5 p.e.s.)

A është poezia çështje femërore?

Nuk ka dyshim se prodhimtaria poetike e dekadave të fundit, në aspektin sasior por edhe atë cilësor po bëhet gjithnjë e më “e mbizotëruar nga femrat”. Veç kësaj, kjo është arsyeja që lejon shfaqjen e vëllimeve voluminoze të mëvetësishme, si ky libër, i cili i kushtohet ekskluzivisht poeteshave greke të cilat kanë lindur në shekullin e 20-të. Në librin e parë të këtij vëllimi u gjykua e nevojshme të përfshiheshin disa poetesha të lindura para vitit 1900, të cilat bëjnë përjashtim, pasi periudha e tyre krijuese është pjesë e pandashme e prodhimitarisë poetike të shekullit XX.

Poezia femërore në bashkëkohësi, pra poezia e shkruar nga femrat, jo vetëm që nuk konsiderohet më si “femërore”, por kërkon vëmendjen tonë si *poezi* pa përcaktime të tepërta. Sigurisht, gjinia përcakton edhe shprehjen e fjalës, së folur dhe të shkruar, por gjinia femërore nuk është më një çështje shkrimore apo thjesht një pretekst për shakara mes poetëve meshkuj.

Në të njëjtën kohë, trajta e shkrimit femëror nga e kaluara zbehet gradualisht, ndërsa dalëngadalë bëhet e kuptueshme se paragjykimet e një shoqërie të dominuar kryesisht nga meshkujt, brenda të cilës ligjërimi kritik, filologjik, gjuhësor, historik mbi poezinë ishte pothuajse ekskluzivisht në duart e seksit “të fortë”, që shpërfillte në mënyrë sistematike kontributin femëror në poezinë greke të shekullit të kaluar. Në të vërtetë, sa poetesha mund të numërohen në listat emërore të “brezave” të ndryshëm të shekullit XX dhe XXI, që riprodhohen nëpër libra filologjikë dhe enciklopedi të ndryshme? Shumë pak, përpara oqeanit të emrave mashkullorë. Për fat të mirë, zgjimi i përgjithshëm i shoqërive ndaj çështjeve të paragjykimeve dhe stereotipave favorizoi daljen nga humnera e lënies pas dore të shumë poeteshave të rëndësishme të shekullit të kaluar. Kështu, u shtuan dedikimet retrospektive, ditët përkujtimore, çdo lloj pune kërkimore brenda dhe jashtë hapësirës universitare. Fantazmat e padukshme nisën të shijonin dritën e vëmendjes që meritojnë. Madje, mund të thuhet me një lloj ironie dhe përmbysjeje historike, se peizazhi i poezisë, siç formulohet nga shekulli XX në shekullin XXI, është një peizazh që formësohet nga gishtat femërorë. Një peizazh që i ngjan poezisë së mirë: i përpunuar bukur, me pak fjalë, i çliruar nga elementët pasurorë të panevojshëm dhe stolisjet e kota, i fortë dhe solid. Kjo poezi e shpreh thelbin e saj me mjetet më të thjeshta. Nuk luan, nuk pranon të përdorë asnjë marifet, nuk bën retorika. Ajo thotë çfarë do, me një ashpërsi dorike. Ndër këto vargje të ashpra, në këtë peizazh poetik spikat një ndjeshmëri e papritur dhe një njomësi joniane. Në faqet që nuk i rreth as era, ndihen erëmmimet e pemëve

të limonit dhe trëndafilave dhe përtej përrenjve dhe dunave me rërë, derdhet poezia e pashtershme, e paanë si deti.

Jemi të mendimit se varianti i cituar më sipër, në paragrafin e Nikos Kazantzakis, karakterizon gjithë shndërrimin e poezisë së shkruar nga femrat në ditët e sotme.

A është bërë, pra, poezia një çështje ekskluzivisht femërore?

Sotiris Pastakas – Stavros Gkirgkenis
Dimër, 2020

* Falënderime të përzemërta për Dimitra Kuvata-n, filologe dhe poete, për redaktimin e zellshëm filologjik të këtij libri. Çdo gabim i mundshëm është përgjegjësia jonë.

LIBRI I PARË
POETESHAT E LINDURA DERI NË VITIN 1945

Katerina Angelaki-Ruk (1939-2020), Melpo Aksioti (1905-1973), Rula Alavera (1942), Mirto Anagnostopulu (1944), Mando Aravandinu (1926-1998), Eleni Vakalo (1921-2001), Ralu Janusopulu (1937-2017), Katerina Gogu (1940-1993), Zefi Daraki (1939), Kiki Dimula (1931-2020), Ifjenia Didaskalu (1916-2016), Kleareti Dipla-Malamu (1897-1977), Angeliki Eleftheriu (1940-2015), Fedra Zampatha-Pagulatu (1934), Hrisanthi Zicea (1902-1995), Nana Isaia (1934-2003), Viktoria Theodoru (1926-2019), Galatea Kazanxaki (1881-1962), Maria Karajani (1936), Olimpia Karajorga (1934), Zoi Kareli (1901-1998), Maria Kentru-Agathopulu (1930), Nina Kokalidu-Nahmia (1920-2002), Sofia Mavroidi-Papadaki (1898-1977), Melisanthi (1907-1990), Rita Bumi-Papa (1906-1984), Mirtiotisa (1885-1968), Athina Papadaki (1945), Jolanda Pegli (1934), Maria Poliduri (1902-1930), Sonia Pilorof-Sotirudi (1944), Zoi Samara (1935), Angeliki Sidira (1938), Anthula Stathopulu-Vafopulu (1909-1935), Lidia Stefanu (1927-2013), Melita Toka-Karahaliu (1940), Amalia Caknia (1932-1984), Andia Franxi (1945), Rena Haxidaki (1943-2003), Maci Haxilazaru (1914-1987)

Katerina Angelaki-Ruk (1939-2020)

LULJA TË MËSON

Çdo gjë trupore e humbet kuptimin e saj
ndërsa lulja e pemës do të thotë gjithmonë diçka;
këmbëngul të çelë dhe të bjerë në tokë,
pa pritur shpërblime personale,
pa llogaritur pavdekësinë e mangët,
ky është fruti...
Sa afër humnerës ndodhet
çdo gjë që lulëzon!
Vallë si është e mundur që lulja
nuk shkon në pikëmbërritjen e saj?
E shkëputur nga fati njerëzor
si ia vendos kurorën mbi krye?
Pse nuk më ngushëllon
kujtesa e syve që adhurova
a do të marr hov
nga të qeshurat mijërapetalëshe të natyrës
ndërsa zvogëlohem me vrull?
*Ah, them me vete, disa të fshehta
i mëson vetëm duke i humbur...*

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

Nga jashtë dua të mësoj
vetëm anët e padukshme të së dukshmes;
peizazhin ta shoh si qendrën e botës
dhe jo më si mbështjellësen hyjnore të “saj”.
Le të më çarmatosë krejt pylli
me llambadhet e tij të blerta
dhe nata
të më pushtojë aq thellë sa qiejt e pafundmë
pa asnjë përkëdhelje...
Le të dalë drita nga të çarat e blerta të gjethnajës
si dikur nga sytë e të dashuruarve.
Ah, kur do të më kaplojë
bukuria gjetherënëse?
Kur do ta mësoj se e gjithë natyra
është dashuri?

NË QIELLIN E HIÇIT ME SHUMË PAK

Përmes vrimës së çelësit tinëz shoh jetën
e gjurmoj fshehurazi mos ndoshta kuptoj
se si ajo del gjithmonë fitimtare
ndërsa ne të gjithë të humbur mbetemi.
Si lindin vlerat
dhe i mbivendosen trupit
që i pari tretet.
Në mendjen time po vdes pa asnjë gjurmë sëmundjeje
po jetoj pa pasur nevojë për asnjë kurajë
po marr frymë edhe pse jam

në distancë të afërt të largët.
Gjithçka e nxehtë që prek, flakëron...
Pyes veten se ç'sajesa të tjera
do të shpikë jeta
mes plagës së shfarosjes përfundimtare
dhe mrekullisë së pavdekësisë së përditshme.
Urtësinë time ia detyroj frikës;
petale, psherëtimë, ngjyresa
flakërij.
Dhé, ajër, rrënjë në dorë mbaj;
që të hyj në qiellin e hiçit
me shumë pak
nuk më duhet asgjë e tepërt.

RËNIA E GJIRIT

Galeria e trupit
nga ku livadhet e zbehta të mishit
llamburitnin më joshëse
në errësirë
kur me sy gjysmë të mbyllur
më dukej sikur dëgjoja enët e gjakut
të zbrazeshin dhe të rimbusheshin.
Ballkoni hyjnor
që rrudhej dhe strukej pas territ
vetëm në dhimbje të madhe
nënçatia e jetës së përditshme
ku një tjetër erë frynte
kishte atëkohë ushqimin e jetës
diçka nga shija e simbolit;

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

Kur gjithçka kthjellohet
lidhja me shpirtin bëhet autonome
një tjetër jetë përvijohet
përherë më përpara ditës
përherë më e guximshme se fati
dhe statujat e shpresës shpërfaqen
me dy lakoret gojëtare.

Gjithçka u rrënuar
u shemb
dhe tashmë jetën e shoh
nga poshtë-lart
shoh që gjithmonë kam pasur
të njëjtin ndryshim të gjirit
me pafundësinë.

VRAJA

Në vend të një ylli, një vrajë shkëlqeu kur u lindi;
dhimbjet që ndjeja në trupin tim të pangjizur
mbrapsht më shtynin në errësirën nistore,
me gishtat e veckël që ngërthyer vdekjen mbanin
si lodër të vogël të shndritshme
zvarritesha këmbadoras në hiç.
Nuk më kujtohet ç'ndodhi dhe si një plagë lulëzova
si mësova në baraspeshë të jetoja
mes qelbit dhe syve të mi të hapur,
kur ime më mendonte se do të më merrte përroi i vdekjes

si gjethja në ujë,
papritmas më pa duke dalë nga terri.
Kush e di se ç'shkëmbime u bënë brenda një nate,
ç'dhashë, ç'mora, nga ç'hoqa dorë,
ç'i premtova jetës që më mbajti si shërbëtoren e saj...
Ishte mujshi, dakordësi, kërcënim,
a duhet t'i jem mirënjohëse apo hakmarrëse jetës
për këtë dhuratë të cunguar të ekzistencës?
Vallë, a më kishin urdhëruar sytë drejt qiellit t'i mbaja
apo t'i ulja poshtë dhe gjithçka të falja?
Ç'të falja, pse? Cila ishte kjo peshë kaq e rëndë
që mbi supe mbaja, para se të nisesha, e turpëruar
apo mos ndoshta kisha marrë një tjetër ngarkesë
dhe çalë-çalë duhet ta çoja deri në fund?

Jetova dhe nisa të luaja.
Me besim mbështetëse në intrigë
dhe ngjitja shkallët.
Në papafingo ngrita mbretërinë e ëndrrave
me figurina të prera.
Firence e quajta qytetin tim magjik,
me zonja elegante dhe zotërinj me kapele.
Pranë derëzës ishte lavamani i banjës
që herë-herë shpërthente si rrufe
mbi zakonet e eteria të heronjve të mi.
Nga poshtë ndihej nxehtësia e kësaj bote,
e gjithë kuzhina me erëmime, zhurma të njohura,
zërat e shtëpisë dëgjoja: Sa është ora? I qërove patatet?
Vetëm kuzhinën dhe imagjinatën time prej letre kisha.
Kaq herët ravijëzohen polet?

TE BERBERI

Si trëndafil i bardhë
peshqiri i berberit
rreth fytyrës tënde
si mizë e ndritshme
në petale ngërthyer.
Tufa-tufa në dysHEME binin
ditët e mia kur të kam dashur shumë
ndërsa berberi llafazan, si esteti i kokës
shkurtonte me gërshërë
çdo gjë të panevojshme
që mugullon me kalimin e kohës.
Ah! Dhe ky i pandërgjegjshmi
të bëri edhe më të bukur;
e tatëpjeta e vetullave u shkrua qartë
dhe nën nefritet e syve
përgjysmë hapeshin lulet e tua, buzët.
Dyqani më ishte ngulitur në kujtesë
në çdo detaj.
Pak nga pak jeta ime pa ty
ishte kthyer në një hiç
që po zvarritej në zonën e parfumuar.
Në pasqyrë pashë fytyrën tënde të qeshur
dhe e copëzuar më dysh u ndjeva
sepse të kisha dhe do të të humbisja
diçka klasike, si jeta që në mes ndërpritet
me një palë gërshërë.

Melipo Aksioti (1905-1973)

KËNGA E DNJEPRIT

Dëgjo, o lumi Dnjepër, çfarë do të themi.
Trimat sovjetikë rropullitë t'i gërmuan.
Peshqit e tu janë të hutuar
plepat e tu erë u bënë
trumcakët u ngurtësuan në kallamishtet e tua
dhe me sytë e vegjël,
çapëlyer përreth vështronin.
Ujërat e tu valë e nxehtë u bënë
kur kurrillat rrëmbyen
dallgët shkumonin male
mure të lartë në vathë i futën
me vite duroi mundi i tyre
deri sa zemrat malli i dogji
e gjithë njerëzia u çiftua në gëzimin e lindjes
duar dhe shpirtra punuan
sytë panë mrekulli që askush nuk i kishte parë,
dhe u formua Dnjepri.
Njëzet vite dritë dhurove.
Derisa lufta shpërtheu.

Është koha e duhur, Dnjepër.
Shkuma jote u bë gjak.
Brigjet e tua gjak pikonin
shtrati yt gjak kullonte
mbrujtur dheu dhe qielli me gjak.

As një orë gjumë nuk bëre.
As një orë nuk u rraskapite të mbartje cofëtina
kuaj të ngordhur, trupa të vdekur,
krahë, këmbë, koka, hekura të thyer, topa,
në brigjet e tua u ngërthyen flamuj të të gjitha kombësive,
por ti, vetëm njërin kishe në mendje: Flamurin e Kuq.

Lavdi brigjeve të tua rebele, ujërave të tu të përgjakur,
shtratit tënd të shkumëzuar, dëshirës tënde të zjarrtë,
që duruan rrënimin, që shqyen Satanain,
që ndihmuan popujt
të kundronin sërish Flamurin e Kuq.

Dnjepër, ka ardhur koha.
Hapi krahët e tu.
Mbyti edha ata të fundit që kanë mbetur,
mbyte demonin e tyre të fundit,
të marrin e tyre të fundit
sharlatanin e fundit
nepërkën e fundit laramane
të veshur me njerëz.

Dnjepër, tani që po të shkruajmë
shpirtin e tij e rëndon një botë e tërë

për ty mendon në ëndrrat e tij të thella,
Dnjepër, pyet veten:

- A do ta kalojnë shokët Dnjeprin?

- Ata nuk do ta kalojnë Dnjeprin...

- Do ta kalojmë Dnjeprin!

Dhe Dnjeprin e kaluan!

Mbi fuçi,

mbi topa, mbi anije pa vela,

një nga një, dy nga dy, mijëra, shumë,

me shpirt ndër dhëmbë

përqaf me pushkët dhe topat

përqaf me shpresat e tyre

duke urryer e në dashuri

në shpirt bartnin besimin e tyre

ndërsa shpresat u zvogëloheshin,

dhe më shumë ankthet, vdekja, erërat,

por, ata përpara bënin, luftonin

këmbëprerë, kokëprerë dhe më nuk u kthyen

të shihnin ç'ndodhte mes tyre

dhe ata luftonin, përparonin

dhe flokët e tyre i merrte era

dhe gjokset e tyre fryheshin

dhe me krahët e tyre fluturuan

frymëprerë

dhe ata këndonin mallin që shpirtin u digjte

dhe ata luftonin, luftonin...

Dnjepër, dëgjo, po të flasim.

Burgjet të përshëndesin.

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

Të vdekurit të përshëndesin.
Të gjallët të përshëndesin.
Punëtorët të përshëndesin.
Fëmijët të përshëndesin.
E gjithë jeta të përshëndet,
sot, nesër dhe ndër shekuj (përgjithmonë).
Dnjepër, lumi i sovjetikëve,
ne njerëzit
të përshëndesim.
Çfarë nuk arrite të bëje dot ti
do ta përfundojmë ne
një natë që do të shkëlqejë
një diell i madh.

RASTËSI

Jetën e kaluam pa ujë, pa pus në oborr,
pa këmisha të qëndisura
edhe pse njerëzit bënin gjëra të tilla në kohën tonë.

Një pjesë të madhe të jetës e kaluam në kafenenë e Shiut
ku për tridhjetë vite
ora e vjetër kishte ndalur në orën shtatë
shokët tanë e shihnin me një besim të shenjtë
duke respektuar
sinqeritetin e saj të madh.

Jetuam në qytet bashkë me peshqit
ku lindën të dashurit e tu.

Burrat bënin vepra vazhdimësie
grave u pëlqenin shumë fëmijët dhe befasi i lindnin të vdekur
kapitenët e hidhnin spirancën herët
sëmundjet e ëmbla i bënin njerëzit memecë
çiftet nuk patën kohë të kungoheshin
të panjohur vendosnin lule në varre
të marrëve iu rikthye kujtesa dhe zemëratë ndjenë,
njëri kujtonte një hundë
një tjetër kujtonte vetullat,
nga fundi i botës kalonin me ngut rrugët,
e mbrapa ktheheshin.

Shpeshherë gjërat e lehta na trembnin
kur i jepnim aq shumë rëndësi jetës
brenda shtëpive të gëlqerosura shkelnim si mbi trëndafila
kishim dhimbje koke
por kurrë nuk e pranuan vullnetplotë
nëse flokët tanë nuk ishin të shndritshëm,
si të marrë vraponim pas vashëzës katërmëdhjetë vjeçare
vrime të fshehura në mur gërmonim
në dritare përgjonim
qentë e ngordhur i shkelmonim kur mundnim, përpara se të
na sulmonin,
si të marrë vraponim për të rrokur gënjeshtat,
për të shmangur kutërbimin e shesheve publike të ndotura
me jashtëqitje
kur dielli lindte në vjeshtë,
përgatiteshim për vdekjen prej kohësh
në tmerr lodheshim të mos braktisnim vashëzat tona
hijeplota të pamartuara,

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

erërat e pazbuluara
që sillnin stuhitë,
e cofëtina mbartnin,
lindje të parakohshme nga frika në fund të detit,
fshikullonin të verbrin me shkopin e tij,
linin pezull armiqësinë,
vullnetplotë bënin gjëra që nuk i donin,
largësitë i ndienim shumë pranë nesh
dhe shtëpi të magjepsura, të shpërndara në kodër,
për vite të tërë asnjë mjek e asnjë ungjill,
në ato netët e humbësirës
urdhëronin gosti.

Po. Njeriu duhet të arrijë gjithçka
para se të largohet
mbi të gjitha rrugën e jetës me mund e durim
pra vdekjen.

Pra, fëmija im, të më shkaktoje rrallë, doje,
pikëllimin e madh,
asgjë të mos dije...

dhe ajo dritarja që kishim në lindje
ishte bërë për melankolinë e pasdrekës mbrëmjeve
aah! dashuria ishte vërtet e vështirë
por ne... e dashuronim.
plakaruqe të çuditshme të shëmtuara
si kukuvajka të verbëra me shumë palë syze
fluturonin të vinin të na shqyrtonin
dhe ç'mesazhe të neveritshme na sillnin,

në ato mesnata anijet i peshonin, thotë, në kantierin detar,
bykët e tyre si sirena të drunjta, të ngurosurra,
gra që prej vitesh përgjonin këmbëhapur
të tjerë i dorëzonin për një grusht pritshmëri,
veshët i bllokunim fort me gishta,
të mos i shihnim, të mos i dëgjonim
ç'do të na thoshin
për foshnjat nën shi
foshnjat që udhëhiqnin të verbërit me urti
dhe me kaq shumë vëmendje
për perdet e bardha në dritare, kur mbulonin sëmundje
tinëzare
ose vizione të mëdha
veprat e papërfunduara
shtëpitë e papërfunduara të njerëzve
njerëzit ikën, u larguan
pa e ndjerë dashurinë e tyre,
statuja mermeri që përqafoheshin dhe lëpinin pikëllimin
nga duart e tyre,
mushmolla të hedhura përtokë e gjethe të verdheme
vjeshtore
që mbulonin tokën me rrënimin e tyre
ne vazhdonim të bllokunim sytë me gishta
të mos shihnim, të mos dëgjonim
lopatat që hapnin gropat ku do të binin shokët tanë
diejt u bënë hëna,
ndërtesa të frikshme agimeve me shiun që binte
si kllloçka të rrjepura nga ankthi,
nga dëshira e tyre,
ndërtesa të larta që preknin qiellin si dashuria, për të cilën

kishin dhënë gjithë jetën dhe
gjinjte e saj të lëshuar
mes nesh kishte pasur gjithmonë disa gjëra
në ç’kohë po jetojmë, vëlla
mes nesh kishte pasur gjithmonë disa gjëra
për të cilat nuk mund të flisnim.

Dallgët na i sollën, dallgët na i morën ëndrrat tona,
më thoni, ç’duhet të bëjmë,
ne jemi gra.
Më thoni, ç’mund të bëjmë, edhe kur
mendonim se ishim zogj,
por, ne jemi gra,
për ne, vitet nuk kalonin, ishte gjithmonë stina e verës,
nuk blinim këpucë të të thoshim “të dua”
kur vërtet nuk kishim asgjë!
Në dritare vendosnim karafila artificialë
edhe nëse brenda nesh gjemba fshihnim
si mace të egra ju kemi dashur.
Mugëtirave i braktisnim klinikat dhe fëmijët tanë
të mos na njihnin
ç’donit nga ne?
Ne jemi gra
shumë na keni hidhëruar.

Shpeshherë seksin tonë e kemi ofruar falas
mes gjetheve të manit
ndërsa qëronim mollë.

Oh, mjeshtër, sikur ta dije se ç’punë e madhe është

të kesh gjithçka në shtëpinë tënde
na e mësoi nëna se njeriut i duhen pesëdhjetë vite pas lindjes
për të lindur
largohuni, tani - na tha nëna
kështu që,
kur vdiqëm, nuk morëm asgjë më shumë
në grushtet tona, sesa puthjet e botës.

Me kaq shumë kujdes mbajtëm brenda shtëpisë tonë
çdo objekt të kotë që
do të na nevojitej vetëm një herë në jetë,
ky ishte argëtimi ynë
ne që kishim folur vetëm për vesën e pranverës
tani që bie shi kaq shpesh,
mos ecni kaq lakuriq.

Ishte një natë dhjetori kur u kthyet tek ne,
kur kishim ndezur qirinjtë,
kur këmbë njeriu nuk kishte
kur në shkollë nuk shkonim
jemi jetimë,
drita e asaj nate shëroi gjithçka
dhe motra jonë tha: - Ndriçoje, motër, të shkojë.

Me teshat e lagura ece nëpër shtëpinë tonë atë natë
nuk të prekëm,
ndërsa në fushat tej lehnin qentë e vetmuar e breronin
kështjellat
një tren ishte nisur natën dhe ata po vinin drejt nesh
në zemër të na preknin thellë

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

në thellësi të saj të horizontit, larg nesh,
nga të harruarit e shumtë, shumë larg nesh,
në një mënyrë të tillë një herë...
atëkohë, u ktheve bashkë me vdekjen tënde.

Zotëri,
lutuni për mëkatet tona
për gjithçka që na ka mbetur
ne e kënduam këngën tonë
ndërsa të tjerët do të vallëzojnë.

Rula Alavera (1942)

BANOR

Ti ishe boja që eksploron
vendin imagjinar
Isha pak dhelparake, me shijen
e shpërndarjes në kalldrëme
Po të takoj, bashkëfajtor i arratisur
i qytetit të vjetër

Vendi ku ndodhemi po kalamendet tashmë.

ATËKOHË

Një zemër e padukshme,
një veprim apo një emër i guximshëm
të pëshpëriti në vesh
të thurje fjetet e patjerra
të arkivolit tënd prej balte.
Ajo që ishte
tani është ngushëllim për Figurën që po vdes,

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

mjegullirën trupore ndiq,
thure dhe armatose
me shëmti të gjallë.

Ngushëllimi im,
fëmija i kujtesës sime më abstrakte, mos më zgjo.
Ende me qumësht nanurisem,
ushqim të ngurtë nuk ha dot.
Rrjeta, pemë të egra,
bar i thatë dhe gjarpërinj më marramendin.
Në terr
rimëkëmbem
si dritë apo edhe si zë.
Si ngjyrë. Si borë e imët.
Mëshirë kam, nuk sakrifikohem në zjarr.
E lodhur nuk jam.
Në grykën e artë reflektimet dhe kujtimet
kanë kohën e tyre t'i rikthehen Zanafillës dhe
Panoramës së kthimit të një Qyteti Krenar.

BRENDA TOPIT TË BORËS BIE BORË

Ftohtësirë.
Milingona të bardha gjurmojnë ata që vijnë.
Ujë borë i bardhë,
reshje bore të bardha.
Arratisje të fshehta,
nota të fshehta luftojnë me të bardhën.

Mendimet e mia të pazbardhura
respektojnë tingullin që bëjnë.
Të nënshtruara
ngërthehen
pas nostalgjisë së ngrirë.

Ëndërimi i zhytur në mendime
ngre në tokën e bardhë flamurin
e paqes apo dorëzimit?
Ftohtësirë

po zbardhem
manteli im i zisë po zbardhet

shpërfillëse,
po dorëzohem.

PAS

Shumë mirë;
viktima e radhës
u rrëqeth deri në vdekje
viktima tjetër eci
duke ndjekur vrasësin
viktima tjetër në vazhdim
e fshiu ligësinë e tij
në mënyrë të pakthyeshme.

SHFRYTËZIM

Përpiqem ta zhvendos shfrytëzimin tim,
të identifikoj, të themi, erën e shiut
ose të kundroj optimizmin e erës tjetër
kush është shumë dhe kush është e pafundme.

Kur të shlyej borxhet që kam,
të gjitha detyrimet,
do ta shtrëngoj fort fatin tim.

Mirto Anagnostopulu (1944)

FILLIM DHE FUND

U shfaq, nuk humba
Humbas, jam shfaqur
Cilën natë kam paguar
Cilin fund
Cilin fillim do të risjell në jetë?

Fillimi dhe fundi nuk janë vetëm dritë

Nuk është tingull, as erë
Dashuri e e shndërruar në diçka tjetër

Janë gurë, dru, ngjyra, toka djerrë
Në çfarëdolloj meteorësh ringjallemi
Në atë që na përket dhe asaj që i përkasim

Barra e papërbushur.

PËRKUSHTIM

Pak rëndësi ka, edhe pse porti mbeti i vetëm
Dhe të verbuara gungat e gjyshit

Izmiri këtu në shtëpi po merr frymë
të na vështrojë me sytë e qiellit
sepse im atë në fëmijë është kthyer sërish
nga një frëngji e ngushtë që mbyllet në dorë
më jep shenjat e motit.

ËNDËRR

Ëndërr
që i mbijetoi Epokës së Metaleve
që rrëshqiti e doli jashtë nga rrjeta e ditës pa ag
me një gjuhë të ashpër bashkëbisedoj
dhëmbët e butë ia shkul një nga një
por ajo si një foshnjë buzëqesh
dhe një vend të fshehtë të kuqërremtë hap
nën gruan
që jam.

KËNAQËSI

Të shënjuar me vulën e saj
figura mitike
unë dhe ti të lidhur
në hunj
dhe përreth
sërish
zjarr.

UNË DUA

Marietës

dua
një batanije të ngrohtë
në vend të kësaj poezie
që shpaloset me thekë të dyshimtë
që kacavaret në çdo gjemb, çezmë apo gozhdë;
një mbulesë serioze njëngjyrëshe
të patejdukshme
dhe indiferente ndaj rrezeve të kujtesës.

Mando Aravandinu (1926-1998)

SHKRIMI A

1

i qartë është kujtimi i asaj dite, e paqartë mbetet ndjesia, të plotë nuk zotëroj kurrgjë. Vetëm hapësira është e imja.

Hapësira është e imja, hapësirë e njohur, shumë pak e lirë, boja në mur e çarë dhe e bardhë, mendoj se e gjithë dhoma ishte e bardhë; pasdite ishte, mesa më kujtohet, mbytëse dhe e nxehtë. Dy njerëz të dashur, dy javë kishin jetuar në hapësirën time të zakonshme, të bardhë.

Në kujtesë, hapësira zgjerohet dhe çliron lëvizjen, zgjerohet në gjatësi, shtrihet, jepet pakëz.

Pjesa tjetër humbet në kthimin e paqartë dhe alternativ të dëshirës, të nxehtësisë së madhe, të lagështirës, të prekjes.

Dëshira është një ndjenjë mbizotëruese.

Ende ekziston njëfarë klime euforie; madje një eufori e tepruar dhe mbulon vetëm njërën, ndërsa tjetra mbetet në buzë të rrethit, e ndriçuar zbehtë, por ende e pranishme,

sipas kësaj përqindjeje të pranisë së pjesëmarrësve; ndoshta ngurojnë dhe mbeten mbrapa.

Në qendër të rrethit të dytë i gjej sërish të dy, njësoj po aq fort të ndriçuar, me një pasion të njëvlershëm, në njohjen më të plotë të trupit, në ritmin e të cilit ndërthuren në mënyrë të përsosur.

Pjesërisht të dyshimtë, ndoshta të befasuar; ata mbeten në qendrën e rrethit të ndriçuar verbërisht, sensualë dhe në pritje.

Kjo nuk do të ndryshojë; e qartë është kujtesa.

Sërish, ndjesia i shpëton kujtesës. Së shpejti do të kaloj në rrethin e tretë dhe të katërt.

Kërkoj ndjesinë e saktë. Filloj sërish.

Pasdrekë e nxehtë, verë, dëshirë, prekje e ndërprerë, eros. Gjatë kthimit, kujtesa lë pas dhimbje therëse.

I mbizotëroj shqisat. Kujtesa dhe fakti bashkëidentifikohen në mënyrë absolute. Unë përfshij tjetrin.

E ndryj tjetrin në pranimin e plotë të vetes, pranimi i tij përcakton ndjesinë, pranimi i tij pa rezerva, në dyshim dhe në mohim, në dhënie dhe në pohim. Thashë pranim dhe jam e qartë, jo identifikim me njeriun e dashur, sidomos me njeriun e dashur.

Me njeriun konkret që ekziston.

Mitologji e pështjelluar, ndoshta e pasigurt, krejt e shpërfytyruar, por paraprakisht pranuese dhe thellësisht bujare.

Në fund, me mitologjinë e dashur.

Sidomos, me njeriun e dashur.

Kjo përcakton kujtesën, kjo përcakton zanafillën, jo fundin e historisë.

Kjo ishte hapësira dhe njerëzit dy, dhe fjala që ekzistonte ndërmjet tyre, e gjerë, e nevojshme, siç shkruhet në dashuri, me kohëzgjatje të gjatë.

Kështu menduan të dy, njësoj.

Cikli i tretë zë një hapësirë më të vogël në kujtesë.

Pikërisht, hapësirën e njeriut të vetmuar që rri në këmbë dhe rrëmon diçka në mes të dhomës.

Thashë vetëm e njeriut.

Dyshimi i prerjes që do të ndajë rrethin dhe kujtesën është hedhur poshtë pa ngurrim, ende nuk ekziston asnjë fjalë e veçantë.

Përveç peshës së veçantë të ndjesisë, askund nuk ndjej se ka prerje, zgjatje apo qoftë edhe ndonjë të çarë.

Pesha e veçantë e ndjesisë shqetëson perceptimin e gjërave të mbetura.

Kthehem sërish në rrethin e tretë më të vogël, e vendosur të verifikoj përmasat e sakta të tij. Këtu e mbizotëroj plotësisht kujtesën dhe aspak ndjesinë.

Gjej sërish hapësirën time të lirë të njohur, të bardhën e çarë të mureve, burrin e dhomës, lakuriq me një parukë të bardhë të dendur.

Shoh rrethin e tretë përmes një syri të xhamtë.

Në këtë rreth ka ajër të filtruar dhe nuk ka vend për pikëpyetje, dyshime apo keqardhje.

Në këtë rreth nuk ka ajër, por ka bindje dhe siguri absolute. Trupi i zhveshur i burrit është i mbuluar me flatra të bukura palloi.

Hapësira është zmadhuar, por unë kam humbur përmasat e saj të vërteta.

Burri fiton në distancë, kotësi dhe arrogancë. Humbet matjet e sakta të rrethit, mbulon të gjithë hapësirën, pyet, përgjigjet, kërkon, shpjegon, i kthehet fjalës së mëparshme, kritikon, mëson, ironizon, largohet nga qendra e ndjenjës, izolohet në qendër të rrethit.

Rrethi i tretë është i gjithi i imi. Në rrathët e tjerë ritmi nuk ka ndryshuar; vetëm duart e burrit e kanë harruar lëvizjen e tyre të parë. E rigjetën lëvizjen.

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

Fakti nuk ekziston. Edhe nëse ekziston, fakti nuk e ka regjistruar në kujtesë çdo element. Fakti ekziston në ndjesi. Ndjesia është fakt; në të gjej përfytyrim të plotë dhe të saktë.

Rrethi i tretë nuk u nda në dysh.
Në rrethin e tretë ka një hapje shumë të gjerë.

Kaloj më lehtë në rrethin e katërt.

Rrethi i katërt dominohet nga frika, nga mungesa e tjetrit dhe shija e frikës. Një pjesë e tij është e mbuluar me një lëndë gëlqerore të bardhë e të trashë.
Pjesa tjetër e rrethit fryhet nga llafazanëria triumfuese dhe paranoja në masë.

Pjesa triumfuese e rrethit të katër të ndarë më dysh ka në qendër një bërthamë të vetme.

Bërthamë qelizore.

Të një qelize të ndryshme në thelb.

Tradicionalisht vetëm ekzistuese.

Në thelb, të një qelize kundërshtari.

Të një qelize të pranuar, në mënyrë shpërdoruese.

Të një qelize uzurpuese të pushtetit.

Të një qelize që nuk lejon asnjë realizim tjetër, përveç atij që i përket ekskluzivisht.

Të një qelize që përjashton paraprakisht dialogun.

Të një qelize, e cila për shekuj është ushqyer me bashkime të paqarta epërsie dhe me pushtetin e mitit.

Me kujtesën u pleks edhe shija e së tashmes me të shkuarën.
Paqartësisht, e gjithë zona ime e hapësirës është fshirë.

Vëllimet janë tretur; ndoshta nuk ekzistojnë.

Zhurma e ventilatorit në cep të letrës që shmanget, përshkallëzon shijen e athët të metalit përreth dhëmbëve.

2

Dëshmia është e pabesë. Kujtesa jo.

Ndjesia topitet; hapësira zgjerohet.

Koha angazhohet.

Dhimbja mbetet e njëjtë.

Ndjesia ende u shmanget gjërave.

Ndjesia e asaj nate.

Ndjesia nuk e mbulon kohën.

Kujtimi numëron dy vjet. Dhimbja mbulon kohën. Dhimbja aktuale e menjëhershme. Ndjesia është pa kujtesë, ndjesia është e përjetshme. E njëjta gjë në atë ëndërr, me ngjyresë të verdhë në bezhë. Në atë ëndërr pa ajër. Të pambarimtë dhe të pafund. E njëjta shije e rërës.

Shija e vdekjes.

Shija e mungesës.

Shija e mungesës së njohur.

Do ta gjeja në kohën e pafundme, me ngjyresë të verdhë në bezhë.

Kështu nisi ëndrra, dhe kjo ishte shija, në ëndërr ndieja dhimbje, në ngjyrë mund të ngulmoj vetëm. Fillimi dhe fundi.

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

Pra, ishte një ngjyrë e verdhë në bezhë e turbullt, joekzistuese. Nuk ishte hapësirë; e përsëris, e pafundme. Askund nuk shihja fund.

Kam ndjesi të vërtetë dhe qartësisht të pafundme.
Unë që e di paraprakisht, para se të fillojë ëndrra, vdekja dhe Mungesa.
Mungesa dhe vdekja, veçanërisht të përcaktuara.

Hapësirën, shijen e rërës, mungesën e ngjyrës, shkretëtirën, gjithçka që synova, i pranova dhe i desha.
Vdekjen dhe Mungesën.
E përsëris, gjithçka e dija dhe asgjë nuk prisja, ashtu siç nuk pret një kokërr rëre, siç nuk mund të frikësohet kurrë likeni i bardhë. Që befas fitoi kujtesë dhe me kujtesën edhe shijen e dhimbjes.
Të gjitha vetitë e tjera të likenit të bardhë i zotëroj plotësisht; madje përfshihem në likenin e bardhë dhe e përfshij atë.

E zotëroj kujtesën, të tashmen dhe të shkuarën.

Atë që ka të bëjë me të dy, Mungesën dhe mua.
Gjithashtu, atë të sigurt dhe konkrete.

Mungesa lëviz në hapësirë. Nuk fshihet askund.
Ndërkaq, ekziston diku afër. Dyshimi i mungonte ëndrrës.

Po kërkoj për Mungesën.

Kërkoj ta gjej.

Unë ose pa asnjë ekzistencë, unë ose pa ndonjë vëllim tjetër
veçse atij, të likenit të bardhë, në kohën e pafundme me
ngjyresë të verdhë në bezhë.

Hapësira është e populluar nga mijëra prani.
Hapësira mbetet e pafundme.

Jam e pranishme, nuk e fshij veten në formë.
Askush, nuk fshihet në ngjyrën pa formë.
Mungesa është afër.

U gjet.

Kujtimi i likenit të bardhë ishte i pari që e dinte këtë.
Hapësira është veçanërisht intime. E angështuar, plot
makthe dhe familjare, e urrej atë gjendjen time të parë.

E urrej formën e likenit. Kërkoj të ekzistoj në formën time
tjetër. Në formën që Mungesa përcakton. Të vetmen që
ende mund ta kujtojë.

Në formën time të parë, jo atë të likenit. Mungesa kontrollon,
mendoj edhe kujtesën. Ankthi zmadhohet, Mungesa është
afër, thujse e prek.

E injoroj formën time.
Fitoj lëvizje të një të mbyturi.
Fshij rrathë të padukshëm.
Përkundem në hapësirë.
Përshkoj format pa lëndë.
Fitoj formën time të plotë.

GJYSMA TJETËR E QIELLIT

Mungesën e rrethojnë dy silueta, në një distancë prej katër hapash. Drejtimi im afrohet drejtpërdrejt me atë të Mungesës. Dyshimi është i pari.

Mungesa nuk kontrollon.

Mungesa nuk zotëron absolutisht asnjë kujtesë.

Shmang vijën e drejtë të kujtesës. Rrëzohem mbi vijën e saj, mbi vijën e Mungesës.

Unë jam në formën time të plotë tani, në atë tjetrën, në formën e të dyve.

Mungesa është e mbushur plot me materie.

Mungesa është një prani e skajshme.

Mungesa e frenoi kujtesën.

Mezi lidh dy shkronjat e para të emrit, mezi i belbëzoj. Po e tradhtoj veten.

Dëshmi e rreme.

Nuk dëgjova, nuk pashë, nuk ishte.

Kishte vetëm shkretëtirë dhe kohë të pafundme.

Mungesa që mohon çdo kujtesë.

Mungesa që mohon kohën e drejtpërdrejtë.

Mungesa nuk më pranoi.

Jo, shorti ishte përcaktuar paraprakisht.

Mungesa e pranoi.

SHKRIMI C

1

Kujtesa është në rrugën e gabuar duke ndjekur lojën e përthyerjes.

Këto kujtime në fillim nuk nënkuptojnë asgjë.

Lojëra sfiduese tingujsh.

Rruga mori butësisht të tatëpjetën, shquaj tingullin e ujit.

Nuk e di të them nëse është kujtesë e ujshme, po pres.

E gjelbra e hapësirës dorëzon kujtesën.

Tinguj degësh të thyera në hapësirën e kujtesës elastike.

Të vegjël zërat e lepurit.

Tingujt e orës përpara hapësirës së zbrazëtisë ajrore.

Heshtje kontrolli dhe heshtje të pandara i paraprijnë kësaj kujtese.

Kjo kujtesë nuk është kujtim mëngjesor.

Është kujtesa e fillimit të mbrëmjes, me ngjyra të njëjta dhe me ngjyresë të përhime asfalti.

Kujtesë frymëmarrjeje në skaj të qafës.

Tinguj që shpërthejnë përpara fjalës.

Fjalë e burgosur brenda fjalës.

Kujtesë e përgjakur heshtjesh.

Ajo: kujtesa e fëmijës.

Kohëzgjatjen e përcaktoi: koha përpara ëndrrës.

Ndjesia: Zgjimi dhe njohja e prekjes.

Tingujt u rikthyen të filtruar, nga hapësira e zbrazëtisë ajrore.

Zbuloj kujtesën e tingujve.

Këto janë pasdreka kujtese të lirë dhe intime me zëra të largët. Zëra nxitjeje.

Ndërprerje të vuajtjeve të mia.

Misteri i të nesërmes së pritshme.

Pasdreka të një vere të gjatë, paralelesh të tjera gjeografike.

Pëshpëritjet u shuan. Qetësi e një fushe të gjerë.

Dhe kujtesa e zbrazët.

Heshtjen e përshkoi ai që i dallonte të gjithë tingujt.

Ai që ngurosi formën e zogjve.

Ai ishte mjeshtër i tingujve. Dhe ishte fjalë mashkullore.

[...]